

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-004/13

Prishtinë, 15 maj 2013

Në çështjen juridike të:

N. D.,

Mali i zi

Paraqitësi i kërkesës / Pala ankuese

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, anëtarë, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/A/152/2012 (lënda e regjistruara në AKP me numër KPA51116 dhe KPA51118), i datës 19 prill 2012, KKPK/D/A/153/2012 (lënda e regjistruara në AKP me numër KPA51117), i datës 19 prill 2012, KKPK/D/A/140/2012 (lënda e regjistruara në AKP me numër KPA51110), i datës 29 shkurt 2012, KKPK/D/A/149/2012 (lënda e regjistruara në AKP me numrat KPA51121, KPA51123, KPA51124, KPA51125), i datës 19 prill 2012, pas shqyrtimit të mbajtur me 15 maj 2013, morri kwtw:

AKTGJYKIM

- 1- Hedhet poshtë si e pa afat ankesa e N. D. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore KKPK/D/A/152/2012, i datës 19 prill 2012, sa i përket lëndëve të regjistruara në AKP me numrat KPA51116 dhe KPA51118.
- 2- Hedhet poshtë si e pa afat ankesa e N. D. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore KKPK/D/A/153/2012, i datës 19 prill 2012, sa i përket lëndës së regjistruara në AKP me numër KPA51117.
- 3- Hedhet poshtë si e pa afat ankesa e N.D. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore KKPK/D/A/140/2012, i datës 29 shkurt 2012, sa i përket lëndës së regjistruara në AKP me numrat KPA51110.
- 4- Refuzohet si e pabazuar ankesa e N. D. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore KKPK/D/A/149/2012, i datës 19 prill 2012, sa i përket lëndëve të regjistruara në AKP me numrat KPA51121, KPA51123, KPA51124 dhe KPA51125 .
- 5- Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore KKPK/D/A/149/2012, i datës 19 prill 2012, sa i përket lëndëve të regjistruara në AKP me numrat KPA51121, KPA51123, KPA51124 dhe KPA51124.
- 6- Obligohet pala ankuese që të paguajë shpenzimet e procedurës në shumën prej 80 € (tetëdhjetë euro) dhe duhet të paguhen brenda afatit prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Me 25 tetor 2007, N. D. ka paraqitur disa kërkesa pranë Agjencisë Kosovare të Pronave (AKP), në mesin e tyre tetë kërkesa që janë objekt shqyrtimi i këtij aktgjykimi dhe përmes të cilave ai ka kërkuar vërtetimin e pronësisë dhe ri-posedimin. Ai ka shpjeguar se i ka trashëguar këto prona, të cilat janë humbur me 13 qershor 1999 si dhe humbja ka qenë si rezultat i rrethanave në Kosovë të vitit 1998/1999.

Në vijim janë paraqitur të dhënat për ngastrat e kërkuara:

Numri i ankesës dhe lëndës në AKP; Numri i vendimit të KKKP-së	Të dhënat për ngastrat
GSK-KPA-A-004/13 (KPA51118) KPCC/D/R/152/2012	Ngastra me numër të panjohur, që gjendet në Pejë, zona kadastrale Brestovik, shtëpi me dy dhoma dhe sipërfaqe prej 60 m ² ;
GSK-KPA-A-005/13 (KPA51116) KPCC/D/R/152/2012	Ngastra me numër të panjohur, që gjendet në Pejë, zona kadastrale Brestovik, shtëpi me tri dhoma dhe sipërfaqe prej 80 m ² ;
GSK-KPA-A-006/13 (KPA51117) KPCC/D/C/153/2012	Ngastra me numër të panjohur, që gjendet në Pejë, zona kadastrale Brestovik, depo në sipërfaqe prej 20 m ² ;
GSK-KPA-A-007/13 (KPA51110) KPCC/D/A/140/2012	Ashtu siç është cekur shprehimisht nga ana e paraqitësit të kërkesës në formën e kërkesës: Ngastra nr.: 216/6, që gjendet në Pejë, zona kadastrale Brestovik, sipas fletës poseduese ngastra që gjendet në vendin e quajtur “Strane” e klasës së 4të, fushë, në sipërfaqe prej 18 ari dhe 88m ² . (Megjithatë AKP-ja pasi që u njoftua nga ana e paraqitësit të kërkesës se ai nuk ishte në dijeni të numrave të ngastrës ka vendosur mbi ngastrën nr: 216/2, ngase kjo është ngastra e cila është cekur në fletën poseduese Nr. 211 të cilës i është referuar paraqitësi i kërkesës)
GSK-KPA-A-008/13 (KPA51124) KPCC/D/A/149/2012	Ngastra me numër të panjohur, që gjendet në Pejë, zona kadastrale Brestovik, livadh në sipërfaqe prej 2 hektar dhe 75 ari;

GSK-KPA-A-009/13 (KPA51123) KPCC/D/A/149/2012	Ngastra me numër të panjohur, që gjendet në Pejë, zona kadastrale Brestovik, e cila sipas formës së ankesës është livadh, ku nuk është cekur sipërfaqja;
GSK-KPA-A-010/13 (KPA51125) KPCC/D/A/149/2012	Ngastra me numër të panjohur, që gjendet në Pejë, zona kadastrale Brestovik, livadh në sipërfaqe prej 1 hektar dhe 60 ari;
GSK-KPA-A-011/13 (KPA51121) KPCC/D/A/149/2012	Ngastra me numër të panjohur, që gjendet në Pejë, zona kadastrale Brestovik, siç shihet të jetë park/ ndërtesë komerciale në sipërfaqe prej 30 m ² ;

Në mbështetje të kërkesës së vetë ai i parashtrori AKP-së dokumentet në vijim:

- Vendimin e padisë së datës 31 maj 2005 të paraqitur nga N.D., M. D., I.D. dhe D. D. si paditës kundër Komunës së Pejës për kompensimin e dëmit prej 217.150 € për pronën e paluajtshme në ngastrën e regjistruar në fletën poseduese Nr. 211 (Ngastrat nr: 22/1, 216/6 [më saktë: 216/2], 216/7, 216/8, 219/1, 225/5, 260/1 në sipërfaqe të përgjithshme prej 1 hektar, 64 ari, dhe 85 m². Paditësi në padi ka theksuar se ata i kanë trashëguar ngastrat si dhe ndërtesat që kanë qenë të ndërtuara në ato ngastra së bashku me orenditë. Për më tepër, paditësit kanë theksuar se ata do ta dorëzonin aktvendimin e trashëgimisë pranë Gjykatës Komonale në Pejë sapo që i njëjti të lëshohej dhe se ata theksuan se me rastin e vizitës së tyre ata e kanë parë se pronë e tyre ishte tërësisht e dëmtuar. Ata u larguan nga prona pas ardhjes së forcave ndërkombëtare në Kosovë pas 26 qershorit 1999.

AKP-ja *ex officio* ka gjetur fletën poseduese nr. 211 të lëshuar nga UNMIK-u me 8 dhjetor 2009, që tregon së paraqitësi i kërkesës ka qenë bashkëpronar i ¼ pjesë ideale të ngastrave në vijim:

Ngastra	Kultivim	Sipërfaqe
216/2	Arë	18 88
216/7	Arë	19 42
216/8	Pyll	6 31
219/1	Pyll	4 37
225/2	Pyll	36
		5 00

		3 24
260/1	Pyll	64 50

Ngastra nr. 216/6, arë në sipërfaqe prej 16 ari dhe 92 m², ishte regjistruar në fletën poseduese Nr. 212 në emrin e një personi të tretë; ngastra nr. 22/1, arë në sipërfaqe prej 42 ari dhe 77 m² ishte regjistruar në fletën poseduese nr: 427 po ashtu në emër të një personit të tretë.

Ngase AKP-ja nuk ka mundur të i njoftoj ngastrat që kërkoheshin për të cilat paraqitësi i kërkesës nuk kishte dhënë numër të ngastrës dhe ka deklaruar se ai nuk mundur të i paraqesë këta numra të ngastrave (KPA51116, KPA51117; KPA51118, KPA51119 dhe KPA51120) ata u përpoqën të merrnin më shumë informacione. AKP-ja i kontrolloi tri raste të paraqitësit të kërkesës pranë Drejtorisë për Pronë dhe Banim, mirëpo edhe aty paraqitësi i kërkesës nuk i kishte paraqitur numrat e ngastrës. Megjithatë, asnjëra nga sipërfaqet e kërkuara nga ana e paraqitësit të kërkesës në këto raste nuk ishte e ngjashme me sipërfaqet e kërkuara nga paraqitësi i kërkesës pranë AKP-së. Duke kontrolluar brenda vetë AKP-së, këta të fundit kanë gjetur se numrat e ngastrave të cekura në padi (dhe fletën poseduese) janë objekt i kërkesave të tjera në AKP.

AKP-ja po ashtu ka kontaktuar disa herë me paraqitësin e kërkesës dhe e ka pyetur atë nëse ai i dinte numrat e ngastrave në rastin e ngastrave që kërkoheshin ishin ngastra të tjera se ato që tashme kërkoheshin përmes kërkesave të tjera dhe për shumicën e të cilave tashme ishte lëshuar vendimi. Paraqitësi i kërkesës u përgjigj se ai nuk i dinte numrat e ngastrës.

1. Lëndët GSK-KPA-A-004/13 (KPA51118) dhe GSK-KPA-A-005/13 (KPA51116)

Me vendimin e KPCC/D/R/152/2012 të datës 19 prill 2012, Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës e ka refuzuar kërkesën KPA51116 dhe KPA51118. Komisioni kishte vendosur se paraqitësi i kërkesës nuk kishte mundur ta vërtetoj të drejtën e pronësisë mbi pronat e kërkuara. Sipërfaqja e ngastrës/ ndërtesës së kërkuar nuk përputhej me ndonjërin nga ngastrat e theksuara në listën e padisë të cilën paraqitësi i kërkesës e kishte parashtruar për ta dëshmuar pronësinë e tij. Paraqitësi i kërkesës nuk i kishte identifikuar ngastrat e kërkuara në formën e pranimit të kërkesës dhe përkundër disa kërkesave nga ana e Sekretarisë Ekzekutive ai nuk e kishte bërë një gjë të tillë.

Vendimi, i cili përmbante paralajmërimin se ankesa duhej të ishte parashtruar brenda 30 ditëve, ishte dërguar tek paraqitësi i kërkesës me 5 tetor 2012.

Me 18 dhjetor 2012, paraqitësi i kërkesës parashtrroi ankesë, duke kërkuar “prej Komisionit” që të nxjerr vendim në bazë të fletës poseduese Nr. 211.

2. Lënda GSK-KPA-A-006/13 (KPA51117)

Me vendimin e KPCC/D/R/153/2012 të datës 19 prill 2012, Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës e ka refuzuar kërkesën KPA51117 (po ashtu edhe kërkesat e tjera të paraqitësit të kërkesës, të cilat megjithatë, siç mund të shihet nuk janë ankimuar). Komisioni kishte vendosur se kërkesa duhej refuzuar ngase paraqitësi i kërkesës nuk kishte mundur ta specifikoj pronën e kërkuar. Edhe pse Sekretaria Ekzekutive kishte kontaktuar disa herë më të dhe kishte kërkuar prej tij që të i specifikoj pronat e kërkuara dhe që t'i siguroj dokumentet shtesë, paraqitësi i kërkesës nuk e kishte bërë një gjë të tillë.

Vendimi, i cili përmbante paralajmërimin se ankesa duhet të ishte parashtruar brenda 30 ditëve, ishte dërguar tek paraqitësi i kërkesës me 5 tetor 2012.

Me 18 dhjetor 2012, paraqitësi i kërkesës parashtroi ankesë, duke kërkuar “prej Komisionit” që të nxjerr vendim në bazë të fletës poseduese nr. 211.

3. Lënda GSK-KPA-A-007/13 (KPA51110)

Me vendimin e KPCC/D/A/140/2012 të datës 29 shkurt 2012, Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës kishte vendosur në lidhje me kërkesën KPA51110 se paraqitësi i kërkesës ishte pronar i $\frac{1}{4}$ pjesë të ngastrës nr. 216/2, në sipërfaqe prej 18 ari e 88 m².

Paraqitësi i kërkesës shprehimisht kishte kërkuar ngastrën 216/6 dhe kishte theksuar se sipërfaqja e tërë ngastrave së bashku ishte 1 hektar, 64 ari dhe 85 m². Megjithatë, ai nuk i kishte siguruar AKP-së fletën poseduese. Fleta Poseduese e UNMIK-ut 211, të cilën AKP-ja e kishte gjetur *ex officio*, nuk përmbante ngastrën 216/6 por ngastrën nr. 216/2. Sekretaria Ekzekutive kontaktoi me paraqitësin e kërkesës. Sipas shënimit në dosje ai ishte përgjigjur se nuk i dinte numrat e ngastrave. Më pas rasti ishte dërguar në procedurë për ngastrën Nr. 216/2.

Vendimi, i cili përmbante paralajmërimin se ankesa duhet të ishte parashtruar brenda 30 ditëve, ishte dërguar tek paraqitësi i kërkesës me 12 qershor 2012.

Me 18 dhjetor 2012 paraqitësi i kërkesës parashtroi ankesë duke kërkuar nga “Komisioni” që të nxjerr vendim në bazë të fletës poseduese nr. 211. Ai e parashtroi Fletën Poseduese 2111,

të lëshuar nga Kadastra e Komunës së Pejës (institucioni paralel) me 11 shtator 2001, e cila përmbante një ngastër 216/6 në sipërfaqe prej 18 ari e 88 m².

4. Lëndët GSK-KPA-A-008/13 (KPA51124); GSK-KPA-A-009/13 (KPA51123); GSK-KPA-A-10/13 (KPA51125); GSK-KPA-A-011/13 (KPA51121)

Me vendimin e KPCC/D/R/149/2012 të datës 19 prill 2012, Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës i ka refuzuar kërkesat KPA51121; KPA51123, KPA51124; KPA51125. Paraqitësi i kërkesës cili i kishte përshkruar ngastrat kontestuese vetëm sipas kultivimit dhe sipërfaqes, megjithatë, jo sipas numrit të ngastrës, nuk kishte dëshmuar pronësinë e tij. Asnjëra nga ngastrat e kërkuara nuk përputhjes me sipërfaqen e ngastrave të vendosura në listën e fletës poseduese nr. 211 (shiko përshkrimin më lartë).

Përkundër kërkesa të shumta të bëra nga AKP-ja tek paraqitësi i kërkesës, AKP-ja nuk kishte pranuar ndonjë informacion prej tij.

Vendimi ishte dërguar tek paraqitësi i kërkesës me 6 dhjetor 2012. Më 12 dhjetor 2012 paraqitësi i kërkesës parashtroi ankesë kundër këtij vendimi, duke kërkuar prej Komisionit që të nxjerr vendim në bazë të fletës poseduese nr. 211. Ai e paraqiti fletën poseduese 2111, të lëshuar nga Kadastra e Komunës së Pejës (institucioni paralel) me 11 shtator 2001.

Gjykata Supreme i ka bashkuar lëndët.

Arsyetimi ligjor:

Mjetet juridike të ndërmarra nga pala ankuese është dashur të interpretohen si ankesa, edhe pse paraqitësi i kërkesës në të gjitha kërkesat e tij kërkon prej “Komisionit” që të nxjerr vendim në bazë të fletës poseduese nr. 211.

Megjithatë, pala ankuese ka përdorur formën të përgatitur posaçërisht për ankesa kundër vendimit të KKPK-së, të adresuar në mënyrë të shprehur tek Gjykata Supreme e Kosovës, mjeti juridik është shprehimisht i përshkruar si “ankesë” kundër vendimit të KKPK-së, pala është përshkruar si “ankues”. Për shkak të tërë këtyre fakteve mjeti juridik nuk mund të konsiderohet vetëm si kërkesë

tek Komisioni që të i rishqyrtoj vendimet e veta, mirëpo si ankesë e cila duhet marr në shqyrtim nga Gjykata Supreme.

1. Lëndët GSK-KPA-A-004/13 (KPA51118) dhe GSK-KPA-A-005/13 (KPA51116)

Ankesa në lëndët KPA51116 dhe KPA51118 është dashur që hedhet poshtë si e pa afat. Neni 12.1 i Rregullores se UNMIK-ut Nr. 2006/50, të ndryshuar nga Ligji Nr. 03/L-079, përcakton si në vijim:

“Brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi ankesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës”.

KKPK-ja me vendimin e vetë KPCC/D/R/152/2012 të datës 19 prill 2012. Ky vendim i wshtw dorwzuar ankuesit me 5 tetor 2012. Sidoqoftw, ankuesi, ka ushtruar ankesw vetwm me 18 dhjetor 2012. Kjo bie jashtë afatit të paraparë në Ligj. Rrjedhimisht, ankesa është dashur të hidhet poshtë si e pa afat (Neni 13.3 i Rregullorws sw UNMIK-ut Nr. 2006/50 e plotwsuar me Ligjin Nr. 03/L-079; Neni 195.1 a), 196 në kontekst me nenin 186.3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Gjykata nuk ka mund të gjej ndonjë arsye pse pala ankuese duhej justifikuar për këtë vonesë. Ai ishte njoftuar në masë të mjaftueshme për afatin (vendimi përmbante paralajmërimin në gjuhen Serbe) si dhe vetë paraqitësi i kërkesës nuk dha ndonjë arsye për këtë vonesë.

Gjykata, megjithatë, dëshiron të shtoj se mjafton që të gjitha ngastrat e cekura në Fletën Poseduese Nr. 211 (paraqitësi i kërkesës kërkon vendimin në bazë të kësaj Flete Poseduese) janë objekt i shqyrtimit sipas kërkesave tjera, për të cilat nuk është dashur që të vendoset këtu. Siç duket për këto kërkesa tashmë është marr vendim në të mirë të paraqitësit të kërkesës ose akoma nuk është marr vendim.

Gjykata vjen në përfundim se: Nëse Kërkesat KPA51116 dhe KPA51118 janë “dublikatë teknik” (objekt i tyre janë shtëpitë e ndërtuara në ngastrat në Fletën Poseduese Nr. 211) atëherë nuk është i nevojshëm vendimi i veçantë (ligjërisht e pamundshme), ose ndërtesat gjenden në ngastra të tjera. Në këtë rastin e fundit paraqitësi i kërkesës nuk ka dhënë ndonjë dëshmi se ai është bashkëpronari i këtyre ngastrave. Shkaku se shtëpisë në sipërfaqe prej 60

m² dhe 80 m² janë të cekura në padinë pranë Gjykatës Komunale në Pejë (në lidhje me këtë Gjykata nuk pajtohet me arsyetimin e vendimit të KKPK-së) nuk është dëshmi e pronësisë.

2. Lënda GSK-KPA-A006/13 (KPA51117)

Për arsyet e cekura në Nr. 1, ankesa në lëndën GSK-KPA-A-006/13 po ashtu është dashur që të hedhet poshtë se e pa afat. Vendimi KPCC/D/C/153/2012 i ishte dërguar paraqitësit të kërkesës me 5 tetor 2012, ai e paraqiti ankesën e vetë me 18 dhjetor 2012 jashtë afatit ligjor të paraparë me nenin 12.1 të Rregullores se UNMIK-ut Nr. 2006/50, të ndryshuar nga Ligji Nr. 03/L-079.

3. Lënda GSK-KPA-A-007/13 (KPA51110)

Për arsyet e cekura në nr. 1, ankesa në lëndën GSK-KPA-A-007/13 po ashtu është dashur që të hedhet poshtë si e pa afat. Vendimi KPCC/D/C/153/2012 i ishte dërguar paraqitësit të kërkesës me 12 qershor 2012, ai e paraqiti ankesën e vetë me 18 dhjetor 2012 jashtë afatit ligjor të paraparë me nenin 12.1 të Rregullores se UNMIK-ut Nr. 2006/50, të ndryshuar nga Ligji Nr. 03/L-079.

4. Lëndët GSK-KPA-A-008/13 (KPA51124); GSK-KPA-A-009/13 (KPA51123); GSK-KPA-A-10/13 (KPA51125); GSK-KPA-A-011/13 (KPA51121);

Ankesa është e pranueshme, megjithatë është e pabazuar.

Vendimi i KKPK-së është i drejtë, gjykata nuk ka gjetur as vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike as zbatim të gabuar të së drejtës materiale apo procedurale. Gjykata pajtohet me KKPK-në se pala ankuese nuk e ka dëshmuar pronësinë mbi pronat e kërkuara. AKP-ja *ex officio* e ka gjetur Fletën Poseduese të UNMIK-ut Nr. 211 të datës 8 dhjetor 2012 që tregon se ngastrat e regjistruara në emër të palës ankuese (dhe Dejan, Ivan dhe Mladen Dasic) si dhe fleta poseduese e UNMIK-ut nr. 212, që paraqesin ngastrat 216 në sipërfaqe prej 16 ari dhe 19 m², të regjistruara në emrin e Milos Dasic si dhe fleta poseduese e UNMIK-ut nr. 472 që e paraqet ngastrën 22/1 në sipërfaqe prej 42 ari dhe 77m² të regjistruar në emër të Shefqet Zenunaj.

Pas vlerësimit të përmbajtjes së lëndës, Gjykata Supreme ka gjetur se asnjëra nga ngastrat e regjistruara nuk përputhet në sipërfaqe me ngastrat e kërkuara (KPA51124: 2 hektar dhe 75 ari; KPA51123: livadh pa sipërfaqe fare; KPA51125, livadh në sipërfaqe prej 1 hektar dhe 60 ari; KPA51121: park/ndërtesë komerciale më një dhomë dhe sipërfaqe prej 30 m²).

Vetë pala ankuese edhe pse u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive, nuk ka dhënë informacione shtesë për ngastrat, mirëpo e ka njoftuar AKP-në se ai nuk i dinte numrat e ngastrave. Ai as nuk i ka specifikuar ngastrat e as qe ka dhënë ndonjë dëshmi në lidhje më pronësinë e ngastrave.

Fleta poseduese 211 e lëshuar nga institucionet paralele me datë 11 dhjetor 2001 nuk paraqet ndonjë dëshmi shtesë.

- a. Gjykata nuk e pranon këtë fletë poseduese si Dëshmi. Neni 12.11 i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50, të ndryshuar nga Ligji Nr. 03/L-079 përcakton: *“Faktet e reja dhe dëshmitë materiale të paraqitura nga cilado palë lidhur me ankesën nuk pranohen dhe nuk shqyrtohen nga Gjykata Supreme përpos nëse tregohet se faktet dhe dëshmitë e tilla me arsye nuk kanë mundur të jenë të njohura për palën në fjalë. Fleta poseduese tashme ishte lëshuar në vitin 2001, paraqitësi i kërkesës lehtësisht ka mundur që ta paraqes Fletën Poseduese tek KKPK-ja*
- b. Për më tepër, fleta poseduese ishte lëshuar nga ana e një institucioni paralel dhe për këtë nga Gjykata nuk pranohet si dëshmi.
- c. Por edhe po ta kishte pranuar Gjykata këtë fletë si dëshmi, kjo gjë nuk do ta ndryshonte vendimin e Gjykatës. Fleta poseduese është shumë e ngjashme me Fletën Poseduese të UNMIK-ut, vetëm emri i ngastrës 216/2 në fletën poseduese të vitit 2001 është 216/6 dhe në fletën poseduese të vitit 2001 është edhe një parcelë më shumë, Nr. 22/1 në sipërfaqe prej 42 ari dhe 77m². Fleta poseduese e vitit 2001 po ashtu nuk përmban ndonjë ngastër që ka sipërfaqen e njëjtë sikurse ngastrat e kërkuara në kërkesat KPA51124, KPA51123 dhe KPA51121.

Shpenzimet e procedurës:

Në bazë të Shtojcës III, nenit 8.4 të Urdhërësës Administrative (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë, një përjashtim i tillë nuk është i paraparë për procedurat para Kolegjit të Apelit. Si pasojë, regjimi normal i pagesës së taksës gjyqësore të paraparë më Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, 3 tetor 1987) dhe me UA Nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi unifikimin e taksave gjyqësore janë të vlefshme për procedurat para Kolegjit të Apelit.

Kështu që, tarifrat e mëposhtme të gjykatës zbatohen për procedurat aktuale të apelit:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 i UA 2008/2): 30 €
- Taksa nga tarifa gjyqësore për nxjerrjen e aktgjykimit (10.1 dhe 10.21 të UA 2008/2) duke pas parasysh se vlera e pronës mbi të cilën Gjykata vendosi për meritat ka mund që për afërsisht të vlerësohet rreth 10.000 €; 50 €.

Këto taksa gjyqësore duhet të merren përsipër nga pala që ka parashtruar ankesë e cila ka humbur rastin. Në përputhje me nenin 46 të Ligjit mbi Shpenzimet Gjyqësore, afati për pagesën e taksave në fjalë nga personi i cili ka vendqëndrim ose vendbanim jashtë vendit nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 ditë e më i gjatë se 90 ditë. Gjykata vendos që në rastin konkret afati është prej 90 ditësh. Neni 47.3 parashihet që në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, pala duhet të paguajë një gjobë prej 50% të shumës së taksës. Në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, atëherë do të kryhet përmbarimi i detyrueshëm.

Këshillë juridike

Në përputhje me Nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë e i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve juridike të rregullta apo të jashtëzakonshme.

Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Elka Filcheva-Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nufer, Referent i EULEX-it